



REPUBLIKA E SHQIPËRISË -AUTORITETI I KONKURENCËS-

Njoftim për Mediat

Mbi Autorizimin e përqendrimit të Sigal Holding me UNIQA

Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e tij të datës 29.01.2008 miratoi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 45.62% të kapitalit aksionar të shoqërisë Sigal Holding Sh.A nga shoqëria UNIQA International Beteiligungs-Verëaltungs GmbH (UNIQA).”.

Ky institucion, pas shqyrtimit të njoftimit të përqendrimit, vërejtë se shoqëria Sigal Holding sh.a përbëhet nga dy shoqëri të sigurimit: Sigal sh.a dhe Sigal Life sh.a, ndërsa UNIQA është një kompani me veprimtari kryesore shërbimet në fushën e sigurimeve (sigurim jete, jo jete dhe risigurime) me qendër në Vjenë, Austri.

Rritja e investimit të huaj në tregun e sigurimeve nëpërmjet përfundimit të kontrollit në shoqërinë Sigal Holding Sh A pritet të sjellë efekte pozitive në zhvillimin e tregut, rritjen e numrit dhe cilësisë së produkteve, përmirësimin e standarteve të ofrimit të shërbimit.

Transaksioni i njoftuar i kontrollit të paketës prej 45.62 % të Sigal Holding sh.a nga UNIQA, nuk sjell asnjë ndryshim në strukturën e përgjithshme të tregut shqiptar të sigurimeve.

Ky përqendrim nuk shkakton efekte anti-konkurrese, dhe në kuptim të nenit 13, pika 1 e Ligjit, nuk krijon pozitë dominuese të ndërmarrjeve të përfshira në përqendrim, pra, nuk ka lidhje shkakësore midis realizimit të këtij përqendrimi dhe krijimit të pozitës dominuese.

Për këto arsye në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës vendosi të autorizojë përqendrimin nëpërmjet shitblerjes së 45.62% të kapitalit aksionar të shoqërisë Sigal Holding Sh.A nga shoqëria UNIQA.

Autoriteti i Konkurrencës ka ndjekur me kujdes zhvillimet në tregun shqiptar të sigurimeve me qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në këtë treg duke u shprehur me anë të disa vendimeve në lidhje me praktikant antikongurrese të evidentuara. Në këtë kontekst, Autoriteti i Konkurrencës do të vazhdojë të monitorojë me kujdes këtë treg edhe në të ardhmen.

Autoriteti i Konkurrencës

Rruga Sami Frashëri, Nr. 4, Kati IV

Tel: 04 / 23 45 04, Fax: 04 / 23 44 97

E-Mail: competition@caa.gov.al, website: www.caa.gov.al